



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

PROJEKT LIGJ

Nr. ____/2018

PËR

**DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR.9355 DATË 10.03.2005 “PËR
NDIHMËN DHE SHËRBIMET SHOQËRORE”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 78, 81 pika 1, dhe 83 pika 1, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, me propozim të deputetit Vullnet Sinaj

**KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

VENDOSI:

Në ligjin nr.9355 datë 10.03.2005 “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore”, të ndryshuar, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

Neni 1

Në nenin 27/1, pika 1 ndryshohet si më poshtë:

“1. Verifikimin e të dhënave të regjistruara nga Administratori shoqëror në Regjistrin Kombëtar Elektronik të të Dhënave dhe në autoritetet shtetërore përgjegjëse për familjet/individët në nevojë, të cilët janë përcjellë nga struktura përgjegjëse për shërbimet sociale në bashki”.

Neni 2

Në nenin 29, pika 1 shfuqizohet

Neni 3

Në nenin 30/1, bëhen ndryshimet si më poshtë:

1. Pika 1, ndryshon me këtë përmbajtje:

“1. Përcjell në Drejtorinë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror, të dhënat e gjeneruara nga administratori shoqëror për familjet/individët në nevojë që kanë aplikuar për ndihmë ekonomike.”

2. Pika 2 shfuqizohet.

Neni 4

Në nenin 31, shkronja “i” ndryshohet si më poshtë:

“ i) të kontribuojnë në procesin e hartimit të projektvendimit për përfituesit e pagesave të aftësisë së kufizuar”

Neni 5

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare

**KRYETARI
GRAMOZ RUÇI**